A joint initiative of the OECD and the European Union, principally financed by the EU

KONFERENCA RAJONALE E VI-të E IPA-s PËRPROKURIMIN PUBLIK

SHËRBIMET PUBLIKE: SI ZBATOHET DHE SI FUNKSIONON DIREKTIVA E BE-SË NË SHTETET ANËTARE

Elizabeth STAVRESKI

elizabethstavreski@hotmail.com

Danilovgrad, Montenegro, 20-21 June 2013

© OECD

Direktiva për Shërbime Publike (2004/17)

aplikohet për prokurimet e shërbimeve, furnizimeve ose punëve në të cilat hyjnë shërbimet publike (d.m.th., organet e caktuara publike dhe private që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare) që kanë të bëjnë me një aktivitet të shërbimit publik

Filozofia bazike

- shërbimet publike që veprojnë në bazë të licencës ekskluzive do të gëzojnë monopol të kompetencave ligjore dhe pothuaj ligjore në fushën e aktivitetit të shërbimit të zgjedhur publik prandaj duhet të kenë të rregulluar çdo prokurim që ato do të bëjnë. Prandaj, nuk janë vetëm subjektet publike ato që duhet të respektojnë rregullat e BE-së lidhur me prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve por edhe subjektet private.
- Megjithatë, ekziston pikëpamja se kur tregu liberalizohet dhe kur ai hapet për konkurrencë nuk ka më nevojë të rregullohet aktiviteti i prokurimit, as i sektorit publik e as i shërbimeve publike të ofruara nga subjektet private
- Duke pranuar natyrën më komerciale të tregut, direktiva është më fleksibile dhe në përgjithësi është më pak e ngurtë,duke përfshirë pragjet më të larta, më shumë opsione për atë se kur dhe si të shpallen mundësitë për kontratë, më pak kontroll mbi zhvillimin e fazave të përzgjedhjes dhe vlerësimit dhe përdorimi më fleksibil i mjeteve për blerje.

Konteksti i shërbimit publik

- Në shumë shtete anëtare të BE-së sektori i shërbimeve publike i është besuar organizatave qeveritare që janë subjekte publike
- Tërësisht private (jo subjekte publike)
- Ekonomi e përzier, me subjekte publike dhe private që veprojnë në treg

3 lloje të subjektit të definuar

- Autoritetet kontraktuese (njëjtë si në direktivën per sektorin publik)
- Ndërmarrjet publike – çdo ndërmarrje mbi të cilën autoritetet publike mund të ushtrojnë ndikim dominues të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për shkak të pronësisë ose pjesëmarrjes financiare
- Subjektet që veprojnë në bazë të të drejtave të veçanta ose ekskluzive
  - Nuk janë autoritete apo ndërmarrje publike
  - Zhvillojnë aktivitet perkates
  - Operojnë në bazë të te drejtave të veçanta ose ekskluzive të dhëna nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar.

Aktivitetet relevante

Uji – aktivitete lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm, përfshirë inxhinierinë hidraulike, drenazhin e tokës dhe trajtimin e ujërave të zeza por jo edhe metodën e furnizimit me uji në shishe.

Energjia – përfshirë funksionimin e rrjetit te fiksuar që ka për qëllim lidhjen, prodhimin, transportimin ose shpërndarjen si dhe furnizimin e energjisë elektrike, gazit, ose ngrohjes. Po ashtu përfshinë hulumtimet me qëllim të nxjerrjes së naftës, gazit dhe thëngjillit.

Shërbimet e transportit – hekurudha, sistemet e automatizuara, tramvaji, trolejbusi, autobusi, hulumtimi i zonave gjeografike për aeroporte, porte detare ose të brendshme ose objektet e terminaleve për transportuesit ajror, detar ose të kanaleve ujore në brendësi.

Shërbimet postare – lejimi, klasifikimi, dërgimi dhe dorëzimi i artikujve postar si dhe menaxhimi i qendrës postare dhe shërbimet logjistike që ofrohen nga subjekti që ofron shërbime postare.

*** kur një subjekt zhvillon ndonjë aktivitet i cili nuk është ‘aktivitet relevant’ kontratat nuk i nënshtrohen Direktivës për Shërbime Publike

Kontratat që përfshihen

- Punët
- Furnizimet
- Shërbimet

Pragjet 5 000 000 euro për kontrata të punës dhe 400,000 për kontrata për furnizim dhe shërbime dhe konkurse te dizajnit.

Procedurat e prokurimit

- Procedura e hapur
- Procedura e kufizuar
- Procedura e negociuar me shpallje paraprake të tenderit

Dispozita për zhvillimin e procesit të prokurimit është më pak e detajuar dhe përshkruese se sa ato të sektorit publik. Për shembull, nuk ka ndonjë kriter shterues për përzgjedhje cilësore, afatet kohore për pranimin e ofertave jane me marrëveshje të ndërsjellë.

Edhe këtu aplikohen parimet e përgjithshme për të siguruar trajtim të barabartë, transparencë dhe për të mos çrregulluar konkurrencën.

Mjetet e blerjes

- Sistemet e kualifikimit – operatorët ekonomikë të interesuar për të bërë kontratë me shërbimet publike aplikojnë që të regjistrohen si ofrues duke përdorur kriteret e paracaktuara dhe te publikuara të kualifikimit
- Marrëveshjet kornizë
- Ankandet elektronike
- Konkursi për dizajn
- Sistemet dinamike të blerjes

Përjashtimet

- Bazuar në konsideratat praktike që kanë të bëjnë me furnizimin ose me shkallën e konkurseve në këto tregje. P.sh., blerja e karburantit për prodhimin e energjisë, blerja e ujit për shërbime të ujit, shërbimet e transportit me autobusë dhe fillimi i shfrytëzimit të naftës dhe gazit
- Ndërmarrjet e kombinuara ndërmjet kompanive në pronësi të përbashkët ose të pavarura – të trajtuara si kontrata "të brendshme" (in house)
- Blerjet për rishitje ose për ri-dhënie me qira
- Direktiva për shërbimet publike nuk aplikohet për kontratat në vendet jashtë BE-së

Përjashtimi sipas nenit 30

- Neni 30 i Direktivës për Shërbime Publike përcakton një përjashtim të përgjithshëm nga Direktiva për Shërbimet Publike të aktivitetit të shërbimit publik në një shtet anëtar në të cilin ai zhvillohet, nëse ai aktivitet specifik “është i ekspozuar drejtpërdrejt konkurrencës në tregjet në të cilat nuk është e kufizuar qasja".
- Ky përjashtim vihet në dispozicion vetëm nëse Komisioni e ka konfirmuar përmes një vendimi formal se në atë shtet anëtar janë përmbushur kushtet e kërkuara për tregun konkurrues.
- Përjashtimet e përgjithshme përfshijnë prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike, kërkimet e naftës dhe gazit dhe ofrimin e shërbimeve postare ekspres dhe të rregullta.

	Treg dhe konkurrencë e liberalizuar	Treg i liberalizuar Operatorët publik janë dominues	Monopol publik	Treg i liberalizuar Operatorët publik janë dominues	Monopol privat
Uji	Estonia	Austria Bullgaria Gjermania Danimarka Hungaria Italia Polonia Rumania Suedia Sllovenia	Belgjika Qipro Republika Ceke Finlanda Greqia Irlanda Lituania Luksemburgu Letonia Malta Holanda Portugalia	Franca	Spanja Sllovakia Britania e Madhe
Energjia	Austria Gjermania Finlanda Luksemburgu Holanda Suedia Britaniae Madhe	Belgjika Estonia Franca Hungaria Irlanda Italia Lituania Polonia Rumania Sllovenia	Qipro Republika Ceke Malta Sllovakia	Bullgaria Danimarka Spanja Greqia Portugalia	

	Treg dhe konkurrencë e liberalizuar	Treg i liberalizuar Operatorët publik janë dominues	Monopol publik	Treg i liberalizuar Operatorët publik janë dominues	Monopol privat
Transport	Republika Ceke Finlanda Lituania Malta Portugalia Suedia Sllovakia Britania e Madhe	Belgjika Bullgaria Danimarka Estonia Franca Hungaria Irlanda Italia Luksemburgu Sllovenia Letonia Holanda Polonia Rumania	Austria Qipro Gjermania Spanja Greqia Portugalia		
Shërbimet postare	Lituania Luksemburgu Holanda	Belgjika Bullgaria Republika Ceke Estonia Spanja Greqia Hungaria Irlanda Italia Letonia Portugalia Rumania Suedia Sllovenia Sllovakia Britania e Madhe	Qipro Gjermania Danimarka Finlanda Franca Polonia		Malta

Shërbimet postare

- Shërbimet postare kohëve të fundit janë liberalizuar dhe monitorohen ngushtë për të siguruar që përfitimet nga hapja e tregut, përfshirë objektivat legjitime të interesit publik, të mos ngatërrohen me praktikat kundër-konkurrencës nga ana e qeverive dhe kompanive.
- Korniza ligjore për Shërbime me Interes të Përgjithshëm Ekonomik – shkurt SHIPE – e cila hyri në fuqi me 31 janar, i mundëson Komisionit të promovojë në mënyrë më aktive efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të caktuara publike, përfshirë shërbimet postare dhe për forcimin e konkurrencën në industri.
- Në janar Komisioni e hodhi poshtë propozimin që UPS të marrë (blejë) TNT Express-in. Marrëveshja e planifikuar, mes tjerash, do të ulëte numrin e kompanive që kontrollojnë rrjetet pan-evropiane të transportit të postës nga katër në tri.
- Shumë kompani evropiane përdorin shërbimet për dërgimin pakove si pjesë të zinxhirit të logjistikës së tyre, kryesisht për dërgesat ndërkufitare. Prandaj është me rëndësi që çmimet e këtyre shërbimeve të mbesin të kufizuara nga konkurrenca e fortë.

Energjia

- Tregu i energjisë ka bërë një progres të konsiderueshëm viteve të fundit kur ekziston një konkurrencë e vërtetë dhe kur energjia elektrike importohet dhe eksportohet gjithandej, ndonëse kryesisht e kufizuar në Evropën Perëndimore.
- Shumica e rrjeteve kombëtare të energjisë elektrike dhe prodhuesve të energjisë janë të kontrolluar nga shteti
- Tregtia ndërkufitare e gazit dhe energjisë elektrike tani është e zakonshme në vendet si Gjermania, Suedia, Franca, Italia, Zvicra, Norvegjia, Holanda, Britania e Madhe, Spanja
- Konkurrenca e vërtetë në tregjet e energjisë në Evropën Qendrore dhe Lindore akoma nuk është bërë realitet.
- Lëvizja drejt një tregu të përbashkët të energjisë dhe zhvillimet në rrjetet e tensionit të lartë në tërë Evropën është prioritet kyç.

- Rregullimi është shumë kompleks dhe nuk ka dy vende që e kanë të njëjtë
- Rregullatorët janë gjithnjë e më kërkues në adresimin e shqetësimeve të konsumatorëve dhe rritjes së çmimeve
- Kompanitë e shërbimeve publike shohin mundësi të konsiderueshme
  - Rritja e kërkesës për energji në tregjet e reja
  - Blerjet ose aleancat për të krijuar kapacitete të reja
  - Rritja e tregjeve të energjisë dhe shërbimeve ndihmëse
- Rreziqet përfshijnë ndërhyrjet politike dhe paqëndrueshmërinë e tregut.
- Shtimi i Marrëveshjeve Kornizë dhe kontraktimit te performancës ku shërbimet publike paraqesin investim kapital që pastaj paguhet përmes kursimeve që bëhen si rezultat i atij investimi, p.sh., instalimi i dritave ekonomike për ndriçimin e rrugëve
- Rritja e globalizimit të investimeve kapitale zvogëlon rëndësinë e aspektit kombëtar lidhur me pronësinë e shërbimeve publike
  Në Britaninë e Madhe 40% e infrastrukturës së aseteve të energjisë, ujit,transportit dhe komunikacionit janë në pronësi të investitorëve të huaj.